

## PASIGURIA/TË DHE QERTHULLI I MBYLLUR I VARFËRISË NË NJË KOMUNITET TË VARFËR TË PAKICËS ROME.<sup>1</sup>

### **Abstrakt**

Në këtë artikull diskutohet një çështje jetike për shumë individë e familje të pakicës rome në Shqipëri, siç është cikli i varfërisë. Artikulli fokusohet në një prej komuniteteve më të varfra të kësaj pakice që jeton në kushtet e varfërisë ekstreme dhe jo e gjithë pakica, duke e lokalizuar si dukuri e duke vlerësuar njëkohësisht heterogjenitetin e pakicës rome në tërësi. Nisur nga graviteti i problemit në të tashmen, i cili ekspozon njëkohësisht të shkuarën dhe ndihmon në eksplorimin e prirjeve të së ardhmes, bëhet përpjekje për të kuptuar se përse ky komunitet gjendet në kushtet e ekonomisë së mbijetesës. Në pamundësi që në këtë artikull të rrokten të gjithë nyjetimet komplekse të dukurisë, trajtohen vetëm disa prej faktorëve të brendshëm që ndikojnë në riprodhimin e vazhdueshëm të pozitës sociale dhe që vështirësojnë mobilitetin social të këtij komuniteti, veçanërisht si pasojë e pasigurive me të cilat ky komunitet përballet. Kjo reflektohet më së shumti në raportin me punën dhe me strehimin. Mbështetur në të dhënat empirike bëhet përpjekje që shkaqet dhe efektet e problemit të emërtohen dhe kategorizohen përmes individit. Në rrafshin teorik fenomeni lexohet përmes konceptit të kapitaleve, fushës sociale, rrjeteve sociale, marrëdhënies pakicë-shumicë dhe habitusit.

**Fjalë kyçe:** Pakica rome, cikli i varfërisë, riprodhim i vetes dhe strukturës, rrjete sociale, kapitale, habitus

### **Abstract**

This article discusses about a crucial issue for many Roma minority individuals and families in Albania such as the cycle of poverty. The article

---

<sup>1</sup> Ky artikull është ripunim i kumesës së mbajtur në konferencën shkencore të Departamentit të Etnologjisë në Institutin e Antropologjisë Kulturor dhe Studimit të Artit me temë: “Pasiguritë e etnologjisë shqiptare”, 18-19 dhjetor 2017.

focuses on one of the poorest groups from this minority: those that live in conditions of extreme poverty, locating it as a phenomenon and considering at the same time the heterogeneity of the Roma minority. Given the gravity of the problem in the present, which simultaneously exposes the past and helps to explore future trends, an attempt is made to understand why this community is in the conditions of a survival economy. Unable to address all the complexity of this phenomenon, this article focuses only on a few of the intrinsic factors that influence the continued reproduction of social status and which hamper the social mobility of this community, especially as a result of the insecurities that it faces. This is mostly reflected in the relation to work and housing. Based on empirical data, efforts are made to name and categorize the causes and effects of the problem through the individual. Theoretically the phenomenon is read through the concept of capital, social space, social networks, minority-majority relations and habitus.

**Keywords:** Roma minority, poverty cycle, reproduction of self and structure, social networks, capital, habitus

### Parashtrim

Artikulli mbështetet në dy burime të dhënash nga terreni:1) Të dhënat e gjeneruara nga kërkimi cilësor mbi romët në Tiranë, banorë të zonës që njihet si Lanabregas, një prej komuniteteve më të varfra të pakicës rome në Shqipëri, që përbëjnë edhe burimin kryesor të të dhënave. 2) Të dhëna që burojnë nga bashkëpunimi e vëzhgimi nga afër i punës së disa prej aktivistëve të shoqërisë civile, organizatave jo fitimprurëse (OJF-të) dhe institucioneve shtetërore të cilët synojnë integrimin<sup>2</sup> e komunitetit të Lanabregasit dhe të pakicës rome në përgjithësi.

---

<sup>2</sup> Pavarësisht shqetësimit për nevojën e problematizimit nga një pikëpamje kritike të nocionit dhe praktikave të integritit si në kontekstin tonë, ashtu edhe më gjerë për të qëndruar brenda kornizave të këtij artikulli kjo çështje nuk diskutohet këtu. Kësisoj, dukuria në fjalë nuk i nënshtrohet filtrave të një analize teorike dhe as diskutimit të gjetjeve që zbulohen nga vëzhgimi empirik, por merret si i mirëqenë, mbështetur në domethëniet që i atribuohen nga shumica e aktorëve pjesëmarrës në këtë hapësirë sociale. Mbështetur në narrativën e prodhuar nga OJF-të, mediat dhe institucionet shtetërore, me integrim kuptohet integrimi në tregun e punës, në

Materiali empirik, i cili mbështetet në burimet e lartpërmendura, pasqyron dy këndvështrime mbi ciklin e varfërisë së këtij komuniteti: nga njëra anë si interpretim nga jashtë përmes tjetrit të përfaqësuar nga OJF-të dhe, nga ana tjetër, si interpretimi i vetë individit që është subjekt i dukurisë. Dallimi në pikëpamje midis aktivistit të OJF -ve (që është njëkohësisht një agjent social në të njëjtën hapësirë sociale) dhe individit rom vlen për të evidentuar asimetrinë në gjykim e në qëndrim midis aktorit që e jeton “këtë jetë” dhe atyre që ndërmjetësojnë për “një tjetër jetë”, ose, e thënë ndryshe, agjentëve që marrin përsipër të mundësojnë integrimin e “të paintegruarve”. Megjithëse nuk është qëllimi i këtij artikulli krahasimi i dy pikëpamjeve që projektohen prej pozitës së ndryshme sociale, dallimet e ekspozuara vetvetëshëm përmes germëzimit të qëndrimeve ndaj dukurisë së marrë në analizë, vlejné, para së gjithash, për të hedhur dritë mbi rëndësinë që mbart fjala e vetë individit apo grupit shoqëror (sidomos kur bëhet fjalë për pakica) në domethënie që i atribuohet sjelljes e qëndrimeve të caktuara, të artikuluara prej vetë atij/asaj.<sup>3</sup>

Gjithsesi, është me rëndësi të theksohet prej fillimit që për shkak të kompleksitetit që mbart dukuria e ciklit të varfërisë, ky artikull është vetëm një pikënisje e problematizimit dhe diskutimit të kësaj çështjeje, vetëm një nga fragmentet e një pune në proces.

Cikli i varfërisë është një çështje që mbart mjaft vështirësi në hulumtim dhe analizë, veçanërisht kur objekti i studimit janë pakicat, kjo për disa arsye:

Së pari, pavarësisht se bëhet përpjekje që problemet, shkaqet e efektet të emërtohen dhe kategorizohen prej vetë subjektit që gjendet brenda ciklit të varfërisë, sapo “gërvishtet” sipërfaqja e dukshme e fenomenit, shfaqet një rrjetë komplekse faktorësh ndikues, që përfshin pashmangshmërisht diskutimin mbi shtetin, strukturën, ideologjitë e historiografinë.

---

aksesin dhe përfitimin e shërbimeve publike, ashtu si edhe ndryshimi i stilit të jetesës në përgjithësi.

<sup>3</sup>Një pikëpamje kjo, që, përpos të tjerash, mbështetet në elementin më bazik të qasjes dhe njëkohësisht ftesës së Geertz-it për ta parë e aplikuar shkencën si interpretative, në kërkim të domethënieve dhe jo si eksperimentale, në kërkim të ligjësiive (Geertz 1973, 5-6).

Së dyti, prej ngarkesës së shumëfishtë që implikon arsyetimi mbi një problem që ka rëndësi jetike për njerëzit, ngarkesë e cila manifestohet dukshëm sa herë përballesh me këtë mjedis social. Për shembull, një javë para se të zhvilloja një vizitë në terren në komunitetin që banonte në baraka, një fëmijë në moshën 6-vjeçare ishte sëmurë rëndë dhe ishte në gjendje kritike për jetën, pasi ishte kafshuar nga miu dhe shërbimin shëndetësor e kishte marrë me shumë vonësë.

Arsyeja e tretë është marrëdhënia delikate e studiuesit me subjektin e studimit, në mënyrë të veçantë kur synohet të bëhet etnografi e një grupi etnik. Kjo për arsyen se studiuesi është njëkohësisht Tjetri, madje për individin rom me të cilin po dialogohet, me gjasa studiuesi përfaqëson Tjetrin. Kjo përforcohet edhe më shumë në mungesë të zotërimit të gjuhës rome, mangësi që me shumë mundësi i kujton vazhdimisht gjatë bisedave romit, faktin që studiuesi është “gaxho”<sup>4</sup>.

Në këtë artikull trajtohet vetëm një nga dimensionet e ciklit të varfërisë, si diskutim i një prej pyetjeve që ka lindur nga puna në terren. A ekzistojnë faktorë të brendshëm që ndikojnë në kultivimin e ciklit të varfërisë dhe që bëhen pengesë për daljen e komunitetit nga varfëria, përpos faktorëve të jashtëm?

Nisur prej kësaj pyetjeje, në tekst, përpos përshkrimit të varfërisë së komunitetit të Lanabregasit, arsyetohet mbi gjetjet, të cilat diskutohen edhe në një rrafsh teorik. Kjo kornizë teorike që është më së shumti një hapje drejt shtigjeve të mundshme teorike në interpretimin e kësaj dukurie, se sa përpjekje për të rrokur e shteruar korpusin e pasur të perspektivave teorike me këtë objekt studimi, gjendet në dy sythet e fundit të këtij artikulli. Konceptet kryesore teorike që diskutohen në këtë artikull, mbështetur në qasjen e Bourdieu-së janë kapitalet, fusha sociale dhe habitusi (Bourdieu dhe Passeron 1990; Bourdieu 2013; Bourdieu 1992; Bourdieu 1986; Bourdieu 1984). Veçanërisht, habitusi përbën edhe konceptin analitik më të rëndësishëm, në përpjekjen për të shpjeguar ciklin e varfërisë, përmes leximit të faktorëve të brendshëm që ndikojnë në riprodhimin e

---

<sup>4</sup> Gaxho është një term që përdoret prej romëve për të dalluar tjetrin që nuk është pjesë e këtij grupi etnik dhe shpeshherë për të identifikuar dikë që nuk është pjesë e kulturës së tyre.

vazhdueshëm të dukurisë në fjalë. Po ashtu, bëhet një ndalesë e shkurtër edhe në autorë të tjerë, si Eriksen dhe Barth (Barth 1969; Eriksen 2005, Eriksen 2001), në trajtimin e linjës etnike të varfërisë, megjithëse qasjet e tyre vetëm sa cekën, për t'u rimarrë në artikuj të tjerë, ashtu si edhe të tjera perspektiva teorike të rëndësishme mbi këtë objekt studimi.<sup>5</sup>

### **Një skicë e varfërisë**

Në këtë artikull, siç nënvizohet edhe më lart, po mbështetem vetëm në të dhënat e siguruar nga etnografia e zhvilluar në terren në komunitetin që banon në zonën e Lanabregasit, e cila është një lagje periferike që shtrihet në lindje të Tiranës. Përpos takimeve të mëhershme e të paprogramuara me individë që aktualisht banojnë në këtë zonë, një komunikim më i afërt dhe më i organizuar, për shkak të rritjes së frekuencës së vizitave në terren, është realizuar në periudhën midis viteve 2016-2019. Kjo periudhë përkon me kohën në të cilën, përpos problemeve të zakonshme që burojnë prej varfërisë ekstreme, shumë prej familjeve u detyruan nga strukturat shtetërore të largoheshin nga vendbanimi i tyre i mëparshëm në Bregun e Lumit. Këtë proces kam mundur ta vëzhgoj nga afër dhe të zhvilloj biseda e intervista të thelluara me 20 individë, burra e gra, të moshave të ndryshme, në kohë të ndryshme. Në funksion të artikullit, në këtë kapitull po ndalem vetëm në një përshkrim etnografik të varfërisë, përmes eksplorimit të marrëdhënies me strehimin, punën dhe arsimin, si elementë që ndihmojnë jo vetëm për të deshifruar arkitekturën e varfërisë, por edhe për të lexuar kushtet në të cilat rutinizohet riprodhimi i kësaj gjendjeje.

Me një përbërje etnike homogjene, komuniteti i Lanabregasit përbëhet nga rreth 60 familje rome. Vetëm dy prej të cilave janë familje mikse, meqenëse njëri prej bashkëshortëve është egjiptian. Janë kryesisht endogame, meqenëse martesat ndodhin brenda të njëjtit grup etnik, ashtu si dhe brenda komunitetit, në qoftë se burri dhe gruaja nuk janë në lidhje

---

<sup>5</sup> Perspektiva të rëndësishme për t'u konsideruar në analizën e ciklit të varfërisë të minoriteteve nga një pikëpamje antropologjike dhe sociologjike janë: Teza e kulturës së varfërisë (Lewis 1959, 1970), teza e racializimit të varfërisë dhe teza e etnicizimit të varfërisë.

gjaku midis tyre. Familjet përbëhen mesatarisht nga pesë anëtarë, nga të cilat familja më e vogël përbëhet nga dy anëtarë ndërsa më e madhja nga dhjetë anëtarë. Formacioni familjar në shumicën e rasteve është e llojit familje e zgjeruar, sepse përbëhet nga të paktën tre brezë që banojnë në të njëjtën strehë. Kjo është edhe rezultat i martesave të hershme që janë një dukuri e zakonshme për këtë komunitet. Shumë prej martesave ndodhin kur vajza dhe djali janë midis moshës 13-16 vjeç. Gjithashtu, ky komunitet është patrilokal, pasi gratë bëhen pjesë e komunitetit përmes linjës së burrit dhe, njëkohësisht, fisnor duke ndjekur të njëjtën linjë, përjashtoj pak raste në të cilat ndiqet linja e gruas.

Komuniteti është krijuar pas viteve '90, nga individë dhe familje me prejardhje nga Elbasani, Fushë-Kruja, Fieri, Korça dhe Tiranë. Më konkretisht, përjashtoj tri familje që e kanë prejardhjen nga Tiranë, të gjitha familjet apo individët e tjerë kanë migruar në drejtim të Tiranës pas rënies së regjimit komunist, për të siguruar apo për të përmirësuar jetesën, ashtu si edhe shumë individë dhe familje të shumicës së popullatës. Si të ardhurit nga zonat e tjera, ashtu edhe individët që banonin në Tiranë, janë detyruar të largohen prej banesës së familjes së origjinës, për shkak të zgjerimit të strukturës familjare. Norma e lartë e lindshmërisë, si pasojë edhe e martesave të hershme, e ka bërë të pamundur bashkëjetesën në të njëjtën banesë. Në mungesë të kapitalit financiar për të ndërtuar apo blerë një shtëpi detyroheshin të lëviznin kudo që mundeshin për të siguruar jetesën, kryesisht brenda hapësirës urbane të Tiranës. Kështu, strehimi ishte situacional dhe i kushtëzuar nga distanca e afërt (vijon të jetë në komunitete të ngjashme) me territore të Tiranës në të cilat ka më shumë mirëqenie. Ndërsa një kriter tjetër i rëndësishëm, si edhe në rastin e komunitetit të Lanabregasit, që dikur jetonte në Bregun e Lumit, është afërsia me ujin, si një element i domosdoshëm për përmbushjen e nevojave bazike jetësore.

### *1. Ndarja e punës*

Ky komunitet prej 28 vitesh angazhohet vetëm në punë të paqëndrueshme dhe informale. Prej ndryshimit të regjimit puna kryesore për shumicën prej tyre ka qenë mbledhja dhe tregtimi i hekurit, mbetjeve të riciklueshme apo, siç njihet në zhargonin e tyre “mbledhja e kanaçeve”, si dhe në pak raste, lypja dhe tregtimi i rrobave të përdorura. Gjithashtu,

pothuajse të gjitha familjet përfitojnë prej vitesh nga skema e ndihmës ekonomike.

Përrjashtojnë individët të cilët në regjimin e shkuar kanë punuar në profesione të ndryshme, individët e tjerë, punët e vetme që njihin dhe në të cilat janë ushtruar gjithmonë janë punët e lartpërmendura. Pas rënies së regjimit komunist, të mbetur pa punë si pjesa dërrmuese e popullatës, të braktisur nga shteti dhe pa asnjë lloj përkrahjeje nga askush, shprehen se nuk kishin mënyrë tjetër për të mbijetuar veç punëve të tilla, si: tregtimi i hekurit, tregtimi i rrobave apo artikujve të tjerë të përdorur. Ata tregojnë se si merrnin hekur për ta shitur nga ndërtesat e rrënuara e të braktisura, që dikur funksiononin si magazina, fabrika apo ndërmarrje të ndryshme; se si bënin tregti rrobash apo artikujsh të tjerë se, ndryshe nga “gaxhejt”, kishin mësuar më herët që ta bënin këtë punë, pasi disa prej tyre e kishin ushtruar këtë aktivitet edhe në regjimin e shkuar.

Puna për mbledhjen dhe tregtimin e mbetjeve të riciklueshme dhe hekurishteve është aktiviteti në të cilin janë angazhuar përgjithësisht të gjithë anëtarët e familjes, madje që në moshë të mitur. Në këtë punë përfshihen edhe gratë, në rastet kur nuk kanë fëmijë të vegjël për të rritur (përgjithësisht fëmijë gjer në moshën 5-6 vjeç), të cilat punojnë bashkë me burrat, ose gra, të cilat, kujdesen të vetme për familjen.

Shpeshherë, prindërit rrëfejnë me keqardhje se si fëmijët e tyre janë rritur pranë kazanëve apo vendgrumbullimeve të mbetjeve. Kryesisht i marrin me vete fëmijët, sepse nuk kanë ku të rrinë gjatë kohës së punës. Në këtë aspekt, gjatë punës së zhvilluar në terren më ka ndodhur shpeshherë që të takoj 12 vjeçarë, kryesisht meshkuj, të cilët pohojnë që merren me atë punë prej moshës 7 vjeçare dhe, megjithëse nuk ishin të kënaqur me kushtet e kësaj pune, e vlerësonin si një aktivitet normal e të dobishëm për ekonominë familjare. Po ashtu, kam biseduar edhe me individë që aktualisht kanë krijuar familjet e tyre dhe që merren me këtë punë që kur ishin fëmijë.

Të ardhurat që mund të sigurohen prej kësaj pune janë rezultat i sasisë së materialeve të riciklueshme që mund të mblidhen brenda një dite, nga lloji i mjeteve që përdoret për transportimin e tyre dhe nga forcat e punës që angazhohen në këtë aktivitet. Shumë prej tyre pohojnë që fitimet e siguruara nga kjo punë dikur ishin më të larta se sa sot. Kjo për shkak të distancës që kanë aktualisht me zona të qytetit, në të cilat dendësia e popullatës dhe

mirëqenia është më e lartë. Gjithashtu, faktori më i rëndësishëm që ka ndikuar në reduktimin e fitimit është moslejimi i ushtrimit të këtij aktiviteti nga Bashkia e Tiranës, në funksion të disiplinimit të trajtimit të mbetjeve të riciklueshme nga kompani të licensuara prej saj. Në katër vitet e fundit shumë prej anëtarëve të komunitetit janë ndaluar, janë gjobitur, iu është sekuestruar mjete i transportit (kryesisht mjetet motorike) dhe materialet e mbledhura.

Lypja, (që, duke iu referuar pohimeve të tyre, është kryesisht e ushtruar si punë nga gratë dhe fëmijët) gjithashtu po bëhet gjithnjë e më e vështirë që të ushtrohet si aktivitet, si pasojë e moslejimit nga strukturat përkatëse të Bashkisë së Tiranës, ashtu si edhe për shkak të distancës së largët me zonat më të pasura të Tiranës. Megjithatë, pak familje që merren me këtë punë gjatë pranverës apo verës emigrojnë në drejtim të Prishtinës e Prizrenit në Kosovë.

Në tregtimin e rrobave të përdorura aktualisht janë të përfshirë pak individë nga komuniteti i Lanabregasit. Kryesisht është një sipërmarrje familjare, por në të cilën gratë angazhohen vetëm kur kanë fëmijë të rritur, kur vajzat më të rritura të familjes kujdesen për më të vegjlit dhe në rastet kur mbajnë të vetme familjet. Mbështetur në pohimet e tyre edhe kjo punë ka pësuar tkurrje si pasojë e ndërhyrjeve të shtetit në reduktimin e aktivitetit informal, zhvillimit të praktikave të reja të konsumit, mbylljen e tregjeve të rrobave të përdorura apo edhe reduktimin e fitimit në tregtimin e tyre në fshatrat afër Tiranës.

Megjithëse të tri tipologjitë e punës janë të pastrukturuara, në qoftë se i krahasojmë me strukturën e zakonshme të një pune formale, prirja e individëve është që të punojnë në bazë të një rutine ditore. Gjer në orët e pasdites në shtëpi mund të gjenden kryesisht nënat me fëmijë të vegjël, vajzat në moshë të mitur që nuk frekuentojnë shkollën, ose individë që nuk zotërojnë aftësitë fizike për të punuar. Megjithatë, koha e punës efektive gjatë një dite pune, kohëzgjatja e pushimit apo pushimeve përgjatë punës, si edhe zonat në të cilat do të punohet, përcaktohen çdo ditë nga vetë individi. Të ardhurat e siguruar nga këto aktivitete ekonomike (përfshijto ndihmën ekonomike) janë ditore. Për rrjedhojë, edhe konsumi është me bazë ditore, në kuptimin që si mundësitë, ashtu edhe prirja dominuese nuk është që paratë të akumulohen dhe të trajtohen si kapital i mundshëm, por të

konsumohen brenda ditës. Individët e intervistuar shprehen se përmes këtyre punëve që janë burimi kryesor i të ardhurave prej të paktën 25 vitesh, ia kanë dalë vetëm të mbijetojnë, ndaj dhe nuk kanë mundur të ndërtojnë një shtëpi apo të akumulojnë kapital.

## 2. *Strehimi*

Gjer në vitin 2016 komuniteti në fjalë banonte në zonën e Bregut të Lumit në Tiranë, e cila shtrihet në anën veriore të qytetit. Në hapësirën përgjatë Bregut të Lumit, rreth 50 familje kishin arritur të ndërtonin dhe të përshtatnin për banim disa objekte banimi të llojit baraka, në të cilat pohonin se banonin prej më shumë se njëzet vitesh, në kushte ekstremisht të vështira. Ndërsa rreth dhjetë familje shprehen se, megjithëse në kushtet e varfërisë ekstreme, ia kishin dalë të ndërtonin shtëpi përdhese.

Duhet nënvizuar fakti se jetesa në këtë territor ishte një prej tablove më përfaqësuese të varfërisë ekstreme, një prej formave më të qarta të manifestimit të varfërisë në hapësirën urbane shqiptare. Sapo i afroheshe këtij mjedisi përballesh me një përzjerje aromash të këqija si rezultat i ndotjes së gjithanshme. Ndotje që shkaktohej nga papastërtitë që sillte lumi, kombinuar me pirgje mbetjesh që mbeteshin pas seleksionimit të materialeve me vlerë dhe ujërat e zeza që rridhnin lirshëm në të gjithë territorin e përbashkët të banimit. Barakat ishin ndërtuar me materiale rrethanore të siguruara kudo ishte e mundur nëpër qytet, kryesisht karton, plastikë, dërrasa dhe, në rastin më të mirë, llamarinë. Kjo e fundit shumë e rrallë, sepse duke qenë e tregtueshme me një vlerë të konsiderueshme, jo vetëm që është vështirë të gjendet, por edhe preferohet të shitet, më shumë se sa të përdoret për të rregulluar barakat. “Çfarë binte jashtë futej brenda në barakë...i sistemonim fëmijët në pjesët e barakës që nuk lageshin nga shiu”, shprehej zonja M. një grua rome rreth të dyzetave. Nga i ftohti dhe papastërtitë përhapeshin shumë sëmundje dhe prej tyre pohohet që në këto kushte ka pasur edhe raste të vdekjes së foshnjave.

Megjithatë, siç edhe rrëfejnë shumica prej tyre, megjithëse në kushte ekstremisht të vështira në Bregun e Lumit, ia kishin dalë të ndërtonin jetën; ishin martuar, kishin lindur dhe rritur fëmijët, megjithëse shteti dhe askush tjetër nuk ishte kujtuar kurrë për ta, përjashto kohën e zgjedhjeve elektorale në nivel lokal apo qendror. Në vitin 2016 njoftohen nga Bashkia e Tiranës se duhet të largohen prej banesave të tyre, sepse do të rregullohej rruga dhe

shtrati i lumit. Banesat ishin ndërtuar në një zonë informale dhe ishin të palegalizuara, madje 50 prej tyre, duke qenë të llojit baraka, ishin edhe të paklasifikueshme prej ligjit si banesa të legalizueshme. Për rrjedhojë, nuk dëmshpërbleheshin, duke rrezikuar që të dëboheshin dhe të mbeteshin të pastrehë.

Si pasojë e kundërshtisë dhe rezistencës në mbrojtje të banesave, të mbështetur nga disa aktivistë romë dhe egjiptianë si dhe OJF-të, komunitetit i premtohet nga punonjësit e Bashkisë së Tiranës mundësia e strehimit në një kompleks banesash që do të ndërtohej në zonën e Lanabregasit. Për shkak edhe të vendndodhjes së vendbanimit të ri që shtrihej në anën tjetër të qytetit, shumica nuk pranonte që të lëvizte nga vendbanimi i Bregut të Lumit, sepse, siç edhe pohonin, “në Bregun e Lumit gjendej gjithë jeta e tyre”. Përpos marrëdhënies emocionale me territorin shumëvjeçar të banimit, arsyeja kryesore e artikulluar prej tyre ishte thellimi i distancës fizike me lagjet qendrore të Tiranës, prej të cilave mund të siguronin më shumë të ardhura përmes mbledhjes dhe tregtimit të mbetjeve të riciklueshme apo edhe lypjes në më pak raste (si burimet kryesore të të ardhurave të trajtuara më lart). Megjithatë, përballë frikës se mund të mbeteshin të pastrehë, alternativa e ofruar ishte e vetmja zgjidhje.

Për një periudhë kohore prej më shumë se një viti, kohë që nevojitej për të ndërtuar banesat e reja në Lanabregas, komuniteti u strehua përkohësisht në një godinë të amortizuar fizikisht, në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Godina ishte një ndërtesë dy-katëshe që në regjimin e shkuar ishte përdorur si magazinë dhe ishte braktisur prej fillimit të post-socializmit. Brenda kësaj strukture u vendosën në të dy katet çadra kampingu për secilën prej familjeve. Në mungesë të ujit të pijshëm, kanalizimeve të ujërave të zeza, tualeteve kolektive e të pamjaftueshme, si dhe amortizimit të godinës në tërësi, u përhapën infeksione dhe sëmundje për shumicën e individëve. Gjithashtu, në këto rrethana, u rrit papunësia dhe u thellua varfëria e, për rrjedhojë, varësia ndaj ndihmës në ushqime dhe në artikuj të tjerë në funksion të plotësimit të nevojave bazike.

Për t’u nënvizuar është se në këtë kohë, gjendja e vështirë që po përjetonin prej dëbimit nga vendbanimi i mëparshëm, pasigurisë për t’u strehuar diku, që përceptohej si e largët dhe pothuajse e pamundur për shumë prej tyre, gjendjes së rënduar shëndetësore, mjerimit në tërësi,

manifestohej në vështirësinë që shfaqej në komunikim me shumicën prej tyre. Në bisedat e zhvilluara në këtë kohë bashkëbiseduesit shfaqnin vazhdimisht shenja nervozizmi dhe një nivel të lartë mosbesimi. Çdo individ që vinte nga jashtë komunitetit shihej si përfaqësues apo si bashkëpunëtor i bashkisë dhe OJF-ve, të cilat në gjykimin e tyre ishin edhe burimi i problemeve me të cilat po përballeshin.

Në dhjetor të vitit 2017 komuniteti u strehua në banesat e reja në zonën e Lanabregasit. Tashmë, jeta e tyre, siç edhe shprehen, fillon të ndryshojë pozitivisht, sepse pas shumë vitesh mund të strehohen në kushte më dinjitoze. Këto ndërtesa janë në pronësi të Bashkisë së Tiranës dhe, në bazë të një kontrate të nënshkruar nga të dy palët, mund të përdoren prej këtyre familjeve si banesa për një kohë të pacaktuar, por me kushtëzimin kontraktual për të mos u shitur, dhënë me qira, apo shkëmbyer. Gjithashtu, detyrime të rëndësishme kontraktuale janë edhe pagimi i energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm, ashtu si edhe arsimimi i fëmijëve.

Në kompleksin e banesave në Lanabregas u strehuan rreth 60 familje në bazë të një ndarjeje, që mbështetej në kombinimin e preferencës për vendndodhjen brenda strukturave përkatëse të banimit me numrin e anëtarëve të familjes. Banesat janë të vendosura në një terren kodrinor, të sistemuara me infrastrukturën bazë si në nivel banese, ashtu edhe për sa i përket hapësirës së përbashkët (kanalizime të ujërave të zeza dhe të bardha, energji elektrike, rrugët e brendshme të shtruara dhe të ndriçuara).

Struktura e ndërtesave ngjan me kapanonet e ushtrisë, megjithëse e ndarë në apartamente specifike. Pavarësisht se është bërë kujdes që ndarja e apartamenteve për njësi familjare, në secilën prej godinave, të bëhet në bazë të përzgjedhjes së fqinjit dhe kriteri i përzgjedhjes në shumicën e rasteve ka qenë marrëdhënia e gjakut, si pasojë e strukturës së këtyre ndërtesave (të ngjashme me kapanonet e ushtrisë) pamundësohet krijimi i një hapësire private të mirëfilltë.

Megjithatë, aktualisht banorët shprehen se këto probleme janë të pakonsiderueshme në krahasim me kushtet e strehimit në të shkuarën, por problem i rëndësishëm mbetet vendndodhja e tij. Distanca me disa prej institucioneve që ofrojnë shërbime të rëndësishme, si shërbimi shëndetësor, ashtu si edhe distanca me territore që dikur konsideroheshin si vende pune, ka krijuar shumë pakënaqësi duke konfirmuar pretendimet e dikurshme të

komunitetit, të artikuluar në momentin që u dëbuan prej banesave të mëparshme. Gjithashtu, kanë ndryshuar fqinjët dhe raporti me tjetrin në përgjithësi. Sipas pohimeve të tyre, megjithëse edhe në Bregun e Lumit jetonin të ndarë nga “dora e bardhë”,<sup>6</sup> pas shume vitesh kishin arritur që të familjarizoheshin me banorët e zonës dhe të paktën të kishin një marrëdhënie normale, ndryshe nga niveli i lartë i diskriminimit që kanë hasur në Lanabregas.

Fqinjët që gjetën në këtë territor janë kryesisht familje të ardhura në Tiranë nga zona të ndryshme të Shqipërisë dhe ku shumica prej tyre kanë ndërtuar shtëpitë para dy dekadash. Prej individëve të ndryshëm nga komuniteti pohohet se marrëdhëniet me fqinjët që gjenden në një distancë fizike të afërt nuk janë të mira dhe madje shpeshherë konfliktuale. Ndërsa me pjesën tjetër që gjendet në një distancë fizike më të largët nuk kanë marrëdhënie ose marrëdhënia kufizohet në ofrimin dhe marrjen e shërbimeve, si në shit-blerjen e mallrave të konsumit apo artikujve të tjerë. Kësisoj, marrëdhëniet e tyre shoqërore janë të kufizuara me individë brenda komunitetit, mes kushërinjve ose me individë të tjerë të pakicës rome që banojnë në ndonjë tjetër zonë të Tiranës.

Aktualisht gjendja e komunitetit të Lanabregasit është përmirësuar për sa i përket kushteve të banimit krahasuar me strehimin e mëparshëm, por është e njëjta, ose në disa raste është përkeqësuar në raport me punën dhe nivelin e të ardhurave. Gjithashtu, detyrimi kontraktual për të paguar energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm e ka rritur barrën financiare për shumë prej familjeve.

Nevoja për punë dhe për të diversifikuar e zgjeruar gamën e punëve të mundshme bëhet edhe më e vështirë të përmbushet, duke konsideruar nivelin e arsimit dhe profesioneve që zotërohen nga komuniteti. Pothuajse 95% e komunitetit janë analfabetë, ndërsa pjesa tjetër ka kryer mesatarisht vetëm dy vite shkollim, përjashtoj një grua egjiptiane, e cila ka përfunduar shkollën e mesme. Po ashtu, shumica e individëve në moshë madhore nuk zotërojnë një profesion se nuk janë ushtruar në asnjë punë tjetër veç punëve të diskutuara më lart. Është vështirë që në këtë aspekt të ndodhin

---

<sup>6</sup> Shprehje që përdoret shpeshherë nga romët për të identifikuar anëtarët e shoqërisë që nuk janë me ngjyrë.

ndryshime edhe në të ardhmen, duke pasur parasysh që shumica e fëmijëve janë analfabetë, sepse nuk e kanë ndjekur shkollën gjatë kohës që jetonin në vendbanimin e mëparshëm.

### **Reaksioni i shkaktuar prej ndërhyrjes nga OJF-të dhe institucionet shtetërore**

Punën e aktivistëve dhe të OJF-ve në raport me komunitetin e Lanabregasit e kam vëzhguar nga afër, ashtu si edhe në kohë të ndryshme mes viteve 2016-2019 kam zhvilluar biseda për të kuptuar më mirë këndvështrimin e tyre. Nisur nga premisa që në kushtet e reja të strehimit të qëndrueshëm, komuniteti i Lanabregasit mund të kalojë në një stad tjetër integrimi, është zgjeruar gama e ndërhyrjes nga organizatat ndërkombëtare e lokale jo fitimprurëse, në bashkëpunim me instancat shtetërore në nivel lokal dhe qendror. Meqenëse, tashmë problemi i strehimit mund të konsiderohet i zgjidhur, fokusi kryesor i ndërhyrjes është reduktimi i varfërisë përmes punës, ofrimit të kurseve profesionale, arsimit të fëmijëve dhe ndryshimit gradual të stilit të jetesës.

Në lidhje me arsimimin, nisur prej vullnetit të vetë komunitetit, ky i fundit vijonte të mos i dërgonte fëmijët në shkollë. Por, si rezultat i masave lehtësuese të ofruara nga OJF-të (transporti, materialet didaktike falas, një vakt ushqim) dhe masave shtrënguese të parashikuara në kontratën e nënshkruar midis Bashkisë së Tiranës dhe komunitetit, fëmijët aktualisht po frekuentojnë shkollën. Duhet theksuar fakti se, referuar komunitetit, si nxitje për të dërguar fëmijët në shkollë, më shumë se sa masat shtrënguese po ndikojnë masat lehtësuese. Kësisoj, nuk është e sigurt nëse kjo sjellje në raport me edukimin formal do të vijojë pas ndërprerjes së mundshme të mbështetjes nga OJF-të. Ndërsa alternativat e punësimit që inkuadrohen në strukturën e zakonshme të punësimit, si punë me orare të programuara, hierarki dhe të ardhura që mund të përftoheshin një herë në muaj, përgjithësisht po refuzohen nga komuniteti. Po ashtu, refuzohen edhe kurset profesionale, megjithëse janë të certifikuar dhe ofrohen falas.

Mbështetur në reagimin që artikullohet prej anëtarëve të komunitetit, shumica e aktivistëve apo e individëve të punësuar në organizata shprehën se, pavarësisht predispozitës së tyre për të ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetesës, duket sikur vetë romët nuk duan të ndryshojnë stilin e

tyre të jetesës. Duke e ilustruar me raste konkrete, një individ pohon se “e ndihmuam zonjën H. që pas shumë përpjekjeve të përfitonte ndihmën ekonomike. Shuma e përfituar nga ky burim është modeste, por ajo çka më shqetëson ishte mënyra se si e konsumon këtë shumë të hollash. Ditën e parë që tërhoqi paratë i harxhoi të gjitha. Kryesisht për ushqime të cilat konsumoheshin në dy ditë, ndërkohë që mund të bliheshin ushqime që të paktën mund të konsumoheshin në një javë”.

Një aktivist pohon se: “meqenëse kishte shprehur vazhdimisht dëshirën e vullnetin për t’u punësuar, e ndihmuam zotin B. që të siguronte një punë të qëndrueshme në sektorin e pastrim-gjellbërimit të Bashkisë Tiranë. Pas një jave u largua nga puna, sepse, sipas tij, nuk mund të presë që rrogën ta marrë një herë në muaj, nuk mund të punoj tetë orë në një vend pune, në një distancë të konsiderueshme nga shtëpia, megjithëse e arritshme me autobus dhe me orare të papërshtatshme, në mënyrë të veçantë turni i natës”.

Po ashtu, në një projekt të një organizate ndërkombëtare në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, që kishte për qëllim punësimin e komunitetit të Lanabregasit në një kompani pastrimi të qytetit të Tiranës, që iu ofrua të gjithë anëtarëve të komunitetit në moshë madhore, fillimisht pranuan 19 individë, prej të cilëve vetëm 7 vijojnë të jenë në punë. Arsyet e refuzimit të kësaj alternative punësimi ishin niveli i pagës i krahasueshëm me të ardhurat që mund të sigurohen përmes punës informale, përfitimi i pagës një herë në muaj dhe, sepse nuk donin të humbnin ndihmën ekonomike (ndihma ekonomike nuk mund të përfitohet në momentin që një anëtar i familjes punësohet në një punë të rregullt). Ndërsa arsyet e largimit nga puna për individët që e pranuan ishin: vështirësia për t’u përshtatur me një punë me rregulla dhe orare që shpeshherë degjeneronte në konflikt me eprorët; paga në fund të muajit; mendësia e burrit në rastin kur e punësuar ishte gruaja dhe emigrimi. Për shembull zoti B. rrëfen se: “më pëlqeu puna, me rregull, me uniformë, por u largova pasi jam futur në borxhe në dyqanin e lagjes dhe rrogën që marr e lë të gjithë atje. Nuk mund të pres dot një muaj, pasi familja ime pret të siguroj ushqimin çdo ditë”. Vetëm dy nga shtatë individët që qëndruan në punë shprehen se ndjehen mirë dhe se arrijnë të përballojnë shpenzimet, si edhe të paguajnë detyrimet për pagesën e ujit dhe energjisë elektrike. Ndërkohë që, tre nga individët e punësuar nuk

kanë mundur të kontribuojnë në përmbushjen e nevojave kryesore të familjes, sepse kanë marrë kredi për telefona, për televizorë apo për artikuj të tjerë që në gjykimin e grave të familjes ishin luks i panevojshëm. Po ashtu, gratë, për dy rastet e tjera, shprehen se burrat e tyre të punësuar në këtë punë, sjellin vetëm një pjesë të rrogës në shtëpi dhe se janë të prirur të kujdesen më tepër për veten dhe më pak për familjen, ndaj dhe nuk i ngelet tjetër mundësi përveçse të vijojnë të dalin për lypje.

Përshkrimi i varfërisë së komunitetit të Lanabregasit në post-socializëm, (si një rast përfaqësues i individëve dhe komuniteteve të kësaj pakice që kanë kaluar përmes një rrugëtimi të ngjashëm), zbardh disa prej treguesve kyç të ciklit të varfërisë. Nga ana tjetër, eksplorimi i ndërhyrjes nga OJF-të dhe institucionet shtetërore hedh dritë mbi llojin e ndërhyrjes dhe alternativave që i ofrohen aktualisht këtij komuniteti për të dalë nga cikli i varfërisë. Sigurimi i strehimit të qëndrueshëm, si eliminim i një prej enëve kryesore ushqyese të këtij cikli, na fton në një territor të ri hulumtimi, sepse përbën një mundësi për të vëzhguar nëse, së pari, është e mundur dhe, së dyti, se si e me çfarë shpejtësie mund të ndryshojë sjellja e individit apo e një komuniteti që ka qenë i shtrënguar të jetojë për një kohë të gjatë në kushtet e ekonomisë së mbijetesës. Kjo është edhe arsyeja kryesore se përse reagimi i komunitetit, prodhuar nga ndërhyrja e aktorëve të shoqërisë civile dhe shtetit, zë një vend të rëndësishëm në këtë artikull. Refuzimi i punësimit të rregullt, mungesa e motivimit për t'u arsimuar si edhe pohimi i aktorëve të shoqërisë civile se këtij komuniteti i mungon vullneti për të ndryshuar, kanë qenë shtysa kryesore për t'u orientuar drejt vektorit të kërkimit që diskutohet në këtë artikull.

Kjo nuk do të thotë që po vlerësohen si të përshtatshme mundësitë e ofruara nga agjencitë e lartpërmendura dhe, aq më pak, po aludohet që reagimi i komunitetit do të jetë i ngjashëm, nëse ofrohen mundësi më të përshtatshme. Siç theksohet edhe në hyrje të artikullit, gjurmimi i motiveve të brendshme është vetëm një nga akset e mundshme të trajtimit të kësaj dukurie që do të plotësohet me artikuj të tjerë me fokus faktorët e jashtëm strukturorë, historikë e situacionalë, dhe inxhinierinë sociale që aplikohet prej shtetit dhe agjencive të tjera me synimin e pretenduar të integritimit të kësaj pakice.

Prej hulumtimit të deritanishëm rezulton që shumica e individëve që janë pjesë e komunitetit të Lanabregasit po refuzojnë të ndryshojnë marrëdhënien me punën, me arsimimin dhe stilin e jetesës në përgjithësi. E lexuar me këtë optikë, të krijohet përshtypja se komuniteti në fjalë, është në një gjendje pezull. Edhe në qoftë se lëviz, kjo i ngjan më së shumti një lëvizjeje të mbyllur brenda vetes, si një përpjekje për të ruajtur habitusin ekzistues. Këtu e kam fjalën për konceptin e habitus të Bourdieu-së, që diskutohet në sythin e fundit të këtij artikulli, duke cituar vetëm një prej nënvizimeve të autorit mbi këtë koncept kur shprehet se: “sepse çdo shije duket sikur është natyrale dhe kështu habitusi i përjashton të tjerët si jo-natyrale duke krijuar një rreth vicioz” (Bourdieu 1984, 56). Për Bourdieu-në shijet, qëndrimet tona, bota e individit në përgjithësi, pavarësisht se është rezultat i kulturës, shpeshherë konsiderohet si e natyrshme prej tij/saj. Kjo natyrisht ushqen pabarazinë sociale sipas principit se disa njerëz janë më të predispozuar për gjëra më të lëvruara apo më të rëndësishme në jetë se të tjerët.

Po ta lexojmë dukurinë nga kjo perspektivë, ngjan sikur një prej grupimeve më të varfra të kësaj pakice beson, ose të paktën ka pranuar, se është e predispozuar “për gjëra më të vogla në jetë” se individë apo grupe të tjera shoqërore.

Nga breznia në brezni, si kultura materiale, ashtu edhe ajo jo-materiale transformohet me një ritëm shumë të ngadaltë. Në këtë aspekt martesat e hershme janë një e dhënë domethënëse. Martesa e vajzës në moshë të mitur është njëkohësisht respektimi i një norme sociale, i tabusë së virgjërisë, ashtu si edhe lehtësim i barrës së ekonomisë familjare. Duket sikur transformimi nuk motivohet së brendshmi, apo qoftë edhe si rezultat i ndërveprimit social. Por, edhe kur ndodh, më së shumti nxitet e, madje, fabrikohet nga agjentë socialë jashtë këtyre mikromjediseve, të cilët prej një pozicioni superioriteti përpiqen të ndërmjetësojnë marrëdhënien me strukturën dominuese. Madje, në këto rrethana mund të supozohet se në këtë ndërveprim subjekti rom është aq shumë i tëhuajzuar, sa raporti nuk fiton për asnjë moment përmasën e marrëdhënies e, për rrjedhojë, nuk bëhet përvojë e rutinizueshme dhe e absorbuar me kohën në kulturë.

E thënë ndryshe, përballë një bote fluide, duke e marrë si të mirëqenë konceptimin e modernitetit të lëngët të Bauman-it, të projektuar në këtë

kontekst, romët e varfër kanë ngrirë apo janë ngurtësuar. Ose, më saktë, pluskojnë në rrjedhën e fluiditetit, por pa mundur të krijojnë realitete sociale apo modele jetese të dekonstruktueshme e të rikonstruktueshme, mbështetur në vullnetin e vizionin e secilit prej tyre. Me pak fjalë, prirjen e këtij grupi, si metaforë mund ta emërtojmë si këmbëngulje për të ruajtur e administruar “këtë që kemi e jemi”, një qëndrim që sjell riprodhimin e qëndrueshëm të pozitës sociale të individit. Këtu nuk e kam fjalën për konceptimin e prirjes për të mos ndryshuar, si rezistencë ndaj vetë strukturës, e cila do të lexohej në një tjetër pikëpamje e përrhyerje teorike, por, më së shumti, formësimin e një qëndrimi të individit dhe grupit që e legjitimon nënshtrimin ndaj kushteve të krijuara prej saj. Ose, më saktë, gjer më tani unë nuk arrij ta gjej nga të dhënat empirike qëndrimin e tyre si rezistencë, por si përshtatje.

Nisur prej kësaj premise, i grishur nga pyetja nëse çka po konstatoja mund të interpretohej edhe si prirje për të ruajtur *status-quo*-në, apo për të administruar gjendjen ekzistuese, kam zhvilluar një pjesë të bisedave me individë të ndryshëm nga komuniteti.

### **Leximi i fenomenit prej kushteve e faktorëve të brendshëm**

Të ftuar të shpjegojnë shkaqet e krijimit të qerthullit të mbyllur të varfërisë, shumica e bashkëbiseduesve nxitojnë me të drejtë të shquajnë si faktorin kryesor shtetin dhe tjetrin në përgjithësi. Ndërsa, nisur prej rolit dhe pozicionit të tyre në këtë proces, referuar disa prej qëndrimeve më përfaqësuese, shpërfaqen të tjerë faktorë me rëndësi.

“Në fillim të viteve ‘90 fitonim shumë para përmes shitjes së hekurit... kishte shumë hekur në gërmadha ndërtesash, ashtu si edhe njerëzit në shtëpitë e tyre. Paratë që fitonim nuk i ruanim, sepse çdo ditë arrinim të fitonim mjaftueshëm ndaj dhe nuk frikësoheshim për të nesërmen”. G. Lanabregas

“Fitonim para, por nuk ditëm të bënim llogaritë mirë siç i bën dora bardhë”. Z. Lanabregas

“Më dëgjo mua, ne romët e kemi mendjen te pija e te qejfi, të kisha ruajtur unë paratë siç bëjnë gaxhejtë kushedi ku isha sot”. R. Lanabregas

“Kur unë kam pasur vështirësi si edhe sot jam mbështetur te të afërmit por edhe të afërmit e mi kanë shumë halle”. I. Lanabregas

“Doja të bëja një operacion se isha shumë e sëmurë, i kërkova ndihmë kushërinjve dhe kujtdo që njihja, por askush nuk më ndihmoi...çfarë të bëjnë; edhe ata si unë janë për bukën e gojës”. V. Lanabregas

Duke u thelluar më tej në dialog, kupton që në fakt kjo marrëdhënie me ekonominë nuk manifestohet kurrësi si mungesë dëshire apo aspirate për më shumë mirëqenie, por shquhet mungesa e dijes dhe e mjeteve e, për rrjedhojë, mungesa e një strategjie për përmbushjen e kësaj aspirate. Gjithashtu, një pengesë tjetër e rëndësishme që identifikohet prej tyre, është mungesa e një rrjeti social tek i cili potencialisht mund të mbështeteshin për të përmirësuar gjendjen e tyre, apo të paktën si pikë mbështetjeje në momente të vështira.

Megjithëse vështirë të deshifrohet kozmosi i dëshirave dhe interesave, dhe aq më shumë të dilet në konkluzione të përgjithësueshme, është lehtësisht e kuptueshme që këtu nuk jemi përballë asnjë të papriture apo evidentimit të ndonjë veçorie specifike të kësaj pakice. Dëshirat e tyre kultivohen dhe marrin kuptim brenda një sistemi vlerash të përgjithshme: duan të kenë një punë më të mirë, më shumë të ardhura, më shumë mirëqenie. Por, përpos artikulimit të dëshirës për një jetë më të mirë e, njëkohësisht, shqetësimit për strategjinë e përshtatshme që do të mundësonte përmbushjen e saj, konstatohet që të jetuarit për një kohë të gjatë brenda ciklit të varfërisë ka rutinizuar një strukturë të brendshme të menduarit dhe të vepruarit që sjell modifikimin e vetë universit të dëshirave dhe interesave. Reagimi ndaj pasigurisë shumëdimensionale të jetësuar gjatë postsocializmit është administrimi i kapitaleve ekzistuese më shumë se sa krijimi i kapitaleve të reja, pavarësisht dëshirave apo aspiratave.

Në intervistat e zhvilluara në Lanabregas shumica e individëve pohojnë se punët e ofruara aktualisht janë më të përshtatshme se punët e ushtruara prej vitesh, si mbledhja dhe tregtimi i mbetjeve të riciklueshme, tregtia e rrobave të përdorura apo lypja, pavarësisht se të ardhurat e siguruar nga të dy tipologjitë janë të krahasueshme. Arsyet kryesore, sipas tyre, janë se punët e rregullta ofrojnë më shumë qëndrueshmëri të ardhurash dhe janë më pak të rrezikshme për shëndetin. Atëherë përse vijojnë të angazhohen në këto punë? Mbështetur në përgjigjet e tyre, zbulohet se në fakt pas shumë vitesh jetese të ndërtuar përmes këtyre punëve, ato jo vetëm

janë të mirëpranuara brenda këtij komuniteti, por, në raport me këtë ndarje pune, është kultivuar edhe një model i caktuar jetese.

I gjendur edhe vetë në këtë kurth, kuptoj që ajo çka në këndvështrimin tim është e papranueshme, për shumicën e anëtarëve të këtij komuniteti është jeta e tyre e përditshme. Në këtë kontekst shprehja që artikullohet rëndom është se “fëmijët kanë nevojë të ushqehen çdo ditë”. E lëvruar prej tyre kjo do të thotë se prej vitesh skema me të cilën sigurohen të ardhurat dhe përkthehen në konsum është me bazë ditore. “Kemi ditë që fitojmë shumë dhe i konsumojmë ose paguajmë borxhet që kemi te dyqani i lagjes dhe pjesën tjetër blejmë gjëra” shprehen shumica e të intervistuarve. Të nesërmen janë të sigurt që do t’ia dalin të sigurojnë bukën e gojës, duke zgjidhur në këtë mënyrë shqetësimin e tyre më të rëndësishëm: mbijetesën.

Gjithsesi, kjo nuk duhet keqkuptuar si përbrendësimi i një modeli jetese dhe përligjja e tij si më e mira (sepse si e sqaruam edhe më lart, nuk mungon dëshira për të dalë prej kësaj gjendjeje), por është krijimi i një mikrorealiteti social të sigurt, përballë pasigurive që mbart realiteti jashtë këtij pragu, megjithëse në kushtet e ekonomisë së mbijetesës. Pavarësisht se të vetëdijshëm e njëkohësisht të shqetësuar për prestigjin e ulët social që implikojnë këto punë, të ardhurat e ulëta e, mbi të gjitha, të paqëndrueshme e të paplanifikueshme, rreziku i shëndetit dhe modeli i jetesës që imponojnë ofrojnë siguri, sepse sipas tyre kjo është “ajo çka dinë të bëjnë më mirë”. Jashtë këtij pragu perceptojnë një shumësi pasigurish që prodhohen së jashtmi dhe së brendshmi, në pikëtakimin e kushtëzimeve objektive dhe përjetimeve e interpretimeve subjektive. Pasiguri që nyjëtohen në një ansambël frikërash të shumëllojshme, si: frika nga diskriminimi apo nga përjashtimi si pasojë e të qenit rom; frika se nuk ka kush i mbron, edhe kur kanë të drejtë; frika që me kapacitetet dhe aftësitë që zotërojnë nuk mund t’ia dalin, pra, thellësisht, frika se mund të humbin edhe këtë që zotërojnë aktualisht.

Kjo përforcohet edhe më shumë nga përgjigja që artikullohet nga shumica e individëve në rolin e prindit, kur ftohen të idealizojnë apo të ëndërrojnë të ardhmen e fëmijëve të tyre. Ajo çka pak a shumë shprehet nga të gjithë është se ëndrra më e madhe për të ardhmen e fëmijëve, është të kenë një punë dhe një shtëpi, pavarësisht llojit të punës apo tipologjisë së shtëpisë. Domethënë, edhe në të ardhmen nuk aspirohen punë apo

aktivitete ekonomike, që do të garantonin një status më të lartë shoqëror dhe mobilitet social drejt një shkalle më të lartë në hierarkinë sociale. Prej kësaj të fundit është e qartë se, edhe rendi i dëshirave e interesave, megjithëse, siç thamë më lart, inkadrohet brenda sistemit vleror dominues, kur agjenti, anëtar i kësaj pakice rreket ta përkthejë me gjuhën e tij/saj apo, akoma më shumë, ta materializojë në realitet, nuk arrin të lëvizë prej aksit botëkuptimor që buron prej pozitës së tij/saj shoqërore aktuale.

Bauman-i, në një analizë të tezës së Marcuses mbi nevojën e çlirimit të individit në përgjithësi në shoqërinë moderne, shprehet se: “të ndihesh i lirë nga shtrëngimet, i lirë t’i bindesh dëshirës sate, do të thotë të arrish drejtpeshimin midis dëshirave, përfytyrimit dhe aftësisë për të vepruar: njeriu ndihet i lirë për aq sa përfytyrimi nuk është më i madh se sa dëshirat e tij aktuale, ndërsa asnjëra prej të dyjave nuk shkon matanë aftësisë për të vepruar” (Bauman 2017, 28). Po këtu, vijon më tej duke shpjeguar se si drejtpeshimi mund të arrihet vetëm në dy mënyra; ose duke pakësuar dëshirat, ose duke zgjeruar mundësitë e veprimit. Kushti në të cilin është i detyruar të projektojë ekzistencën ky komunitet, është rezultat i pamundësisë për të zgjeruar spektrin e mundësive të veprimit, duke kufizuar dëshirat, për të ruajtur drejtpeshimin social të kushtëzuar nga jashtë.

Treguesi më domethënës që konfirmon argumentin është pikërisht marrëdhënia me edukimin formal. Në qoftë se për shumicën e individëve në moshë madhore mungesa e ambicies mund të shpjegohet me aftësitë që zotërojnë edhe si pasojë e mungesës së edukimit formal ose edukimit në një nivel të ulët, nevojitet të shpjegohet se përse kjo projektohet edhe te fëmijët e tyre. Pavarësisht se aktualisht fëmijët në Lanabregas po e frekuentojnë shkollën, si pasojë e detyrimit kontraktual dhe lehtësirave mbështetëse të cilat sqarohen më lart, prindërit shprehen se nuk e vlerësojnë arsimimin si zgjidhje të problemeve të tyre sot apo në të ardhmen. Kësisoj, siç do të shohim edhe në sythin pasardhës, në mënyrë të veçantë marrëdhënia me edukimin manifestohet si nënshtrim ndaj gjendjes ekzistuese, pothuajse si pranim se kjo është “ajo çka na përket”.

Të jetuarit për një kohë të gjatë në kushtet e varfërisë ekstreme ka rritur pasigurinë e, për rrjedhojë, përligjen e nënshtrimit ndaj kushteve ekzistuese dhe rutinizimit të këtij modeli jetese, duke pamundësuar mobilitetin social e duke stabilizuar kushtet për riprodhimin e pozitës

ekonomike e sociale të këtij grupi shoqëror. Kësisoj, përpos faktorëve të jashtëm që ndikojnë në krijimin e kësaj gjendjeje, faktorët e brendshëm që filtrohen prej analizës së deritanishme, mbështetur në pohimet dhe qëndrimet e individëve të ndryshëm janë:

- a) Mungesa e *dijes, kapitaleve të tjera dhe rrjetit social* për t'iu përgjigjur dhe për të vepruar me një strategji të përshtatshme në kushtet e sistemit të ri në post-socializëm.
- b) Pasiguria. Sa më shumë kohë kalohet në varfëri, aq më shumë rritet *pasiguria* në përgjithësi dhe, për rrjedhojë, vulnerabiliteti e frika ndaj ndryshimit.
- c) Rutinizimi. Si pasojë e kushtëzimeve objektive, rutinizimi me kohën i një modeli jetese që është rezultat i nënshtimit ndaj kushteve ekzistuese, shpie në *administrimin e ekzistencës në të tashmen, në mungesë vizioni, plani apo edhe ambicije për të ardhmen* dhe, për pasojë, në riprodhimin e vazhdueshëm të vetes.

### **Raporti shumicë– pakicë, rrjetet sociale dhe kapitalet**

“Ju mund t’ia shtrini dorën njëri tjetrit për ndihmë,  
por ne nuk kemi kujt t’ia shtrijmë dorën”.

Banore në Lanabregas, Tiranë

Është me rëndësi të kujtojmë sërish, që nuk kemi të bëjmë vetëm me një grupim shoqëror çfarëdo, por me një pakicë etnike të margjinalizuar. Ndaj, dhe nisur prej kësaj premise, nuk mund të kuptohet përfitimi dhe zotërimi i kapitaleve pa u nisur prej të shpjeguarit të marrëdhënies së pakicës me shumicën. Sipas Eriksen-it: “Etniciteti mbetet një princip themelor në organizimin e jetës sociale. Kufijtë etnikë mbajnë rrjete dhe komunitete morale të bazuara në besim dhe detyrime, burime kulturore dhe një sistem të sigurisë sociale” (Eriksen 2005, 368).

Nëse e lexojmë fenomenin sipas kësaj perspektive, mbështetur edhe në vëzhgime të tjera empirike në të cilat kam marrë pjesë (Çeka dhe Kaçiu 2015), rezulton se kusht i rëndësishëm në kultivimin e kapitaleve gjatë socializmit dhe në post-socializëm bëhet lloji dhe shkalla e ndërveprimit me pjesën tjetër të shoqërisë. Domethënë, tejkalimi i rrjetit të mbyllur të paracaktuar prej kufirit etnik, megjithëse shpesh mund të fitojë trajtat e

asimilimit, është njëkohësisht edhe “shpëtim” prej të jetuarit në skaje të shoqërisë, si një trajektore që garanton shumë më tepër mobilitet social. Thënë kjo, duket sikur ekzistojnë dy shtigje nga janë të destinuar të kalojnë pakicat (në mënyrë të veçantë pakicat e marginalizuara), asimilim ose segregim. Eriksen shkon edhe më larg kur shprehet se: “Ndarja etnike e punës është rezultat i segregimit dhe integritit, por vetëm asimilimi dhe disa forma të integritit mund të sigurojnë pjesëmarrje të plotë politike në shoqëri.” (Eriksen 2001, 285)

Në mënyrë të veçantë, në kapërcyell të regjimit të kaluar, parakusht për pozitën sociale të individit në rendin e ri bëhet natyra e rrjetit social, që mund të angazhohet në ruajtjen dhe përfitimin e kapitaleve të reja. Sa më të mbyllura rrjetet sociale, dhe në mënyrë të veçantë sa më të kushtëzuara prej kufijve etnikë, aq më të destinuara të vuajnë prej segregimit fizik dhe social.

Në këtë kontekst, komunitetet rome që kanë jetuar më pranë mazhorancës dhe kanë ndërvepruar gjerësisht, si në mjedisin e përbashkët komunitar dhe atë të punës në të kaluarën, kanë pasur më shumë eksperiencë pune të qëndrueshme në sektorin shtetëror, më shumë arsim, zotërim më të mirë të gjuhës shqipe, marrëdhënie më të afërt me mazhorancën dhe, si rrjedhojë, më shumë kapitale për t’u përballuar gjatë post-socializmit. Ndërkohë, të gjithë këta tregues janë më të zbehtë, ose tërësisht jo të pranishëm për komunitetet rome, që kanë jetuar më të izoluar nga ndërveprimi me mazhorancën, siç janë edhe grupet e marra në analizë.

Në këto rrethana, për këtë grupim të pakicës rome, në mënyrë të veçantë kapitali kulturor i domosdoshëm në rrethanat e tranzicionit, reduktohet në zotërimin e disa njohurive dhe instrumenteve bazikë që garantojnë mbijetesën. Grupimet brenda komunitetit rom, që kanë ndërvepruar dhe ndërveprojnë më shumë me mazhorancën, jo vetëm që përfitojnë më shumë nga kapitali i përbashkët i shoqërisë, por kanë mundësi që duke u bërë pjesë e rrjeteve informale, të cilat në tranzicion kompensojnë keqfunksionimin e shtetit, të sigurojnë më shumë akses në të mirat e përbashkëta<sup>7</sup>.

---

<sup>7</sup> Gjithsesi duhet theksuar që këtu po flasim për sukses apo integritet relativ edhe të këtyre segmenteve të këtij minoriteti. Për shembull, nuk kemi në gjithë historinë e

Në këtë vektor arsyetimi, është për t'u nënvizuar se, jo rastësisht, Barth-i në një ese që ka influencuar jo pak perspektivën e studiuesve në trajtimin e etnicitetit, nënvizon domosdoshmërinë e kërkimit mbi grupet etnike, nisur prej kufijve socialë dhe jo tipareve substanciale kulturore. Përmes argumentimit të perspektivës së tij Barth sugjeron që të ndryshojmë vektorin e kërkimit, duke u fokusuar në proceset sociale, e cila ndryshe nga perspektiva që niset prej dallimeve kulturore, shpalos ekzistencën e një marrëdhënieje ndëretnike dinamike dhe të negociueshme (Barth 1969, 11-16). Domethënë, identiteti kulturor i individit nuk është “i gdhendur në gur” dhe nuk përcakton rolin dhe pozitën shoqërore të individit, por ai mund të ndryshojë (ose të mbetet i njëjti) në varësi të ndërveprimit me tjetrin.

Po në të njëjtën linjë Eriksen argumenton se etniciteti është komponent i rëndësishëm i identitetit (siç citohet edhe më lart), por nuk përcakton identitetin social të individit. Një individ mund të jetë pjesë e grupeve sociale të ndryshme, për pasojë identiteti i tij mund të jetë shumë shtresor, nga të cilat përkatësia etnike është vetëm njëra prej nënshtresave (Eriksen 2001, 272).

Vështirë të deshifrohet marrëdhënia e pakicës me shumicën e popullatës pa lexuar edhe marrëdhëniet e pushtetit që ajo implikon. Siç shprehet Eriksen, “Shumica përcakton strukturën e duhur kulturore për karrierën dhe, kësaj, zotëron edhe një surplus të kapitalit simbolik kundrejt pakicës” (Eriksen 2001, 285).

Marrëdhënia me shumicën është, në një formë apo një tjetër, përcaktuese për suksesin ose dështimin e individit që është pjesë e pakicës. Kjo, sepse ndërveprimi me mazhorancën nënkupton pjesëmarrje në një rrjet më të gjerë mundësish, si akses në teritore kapitalesh që, në të kundërt, do të ishin të pamundura të arriheshin. Për individët që nuk arrijnë të dalin përtej kufijve të minoritetit të marginalizuar e të zgjerojnë rrjetin e tyre social, duke qenë të izoluar brenda këtij kapitali social bëhet më e vështirë që të çlirohen nga status-quo-ja. Duhet theksuar që kjo nuk është zgjedhje e vullnetshme e këtij komuniteti, por rezultat i ndërveprimit të kufizuar me

---

Shqipërisë asnjë rom në struktura drejtuese, në profesione të vlerësuara financiarisht apo me prestigj të lartë shoqëror.

pjesën tjetër të shoqërisë si pasojë e distancës fizike, ekonomike, sociale e kulturore, që me kalimin e kohës thellohet edhe më shumë.

### **Kapitalet, fusha sociale dhe habitusi: Aplikimi i aparatit konceptual bourdieu-nian si një prej leximeve të mundshme të ciklit të varfërisë**

Me kapital të ulët ekonomik social dhe kulturor, sipas kuptimit që i jep këtyre koncepteve Bourdieu, ky formacion shoqëror veçohet gjithnjë e më shumë nga pjesa tjetër e shoqërisë. Të jetuarit në skaje të shoqërisë, të izoluar si pasojë e natyrës së ndërveprimit me të tjerët, këto grupime bëhen vetëreferenciale. Racion për veprimet e qëndrimet e tyre, këta agjentë socialë, në kuptimin e motivimit dhe legjitimitimit të sjelljes, e kërkojnë dhe e marrin brenda këtij grupimi të ngjashmish. Çdo entitet që shtrihet jashtë fushës sociale në të cilën kanë mundësi të veprojnë, perceptohet si i largët e, si i tillë, me kohën rresht së qeni pjesë e universit të dëshirave, ambicieve apo modeleve sociale për t'u ndjekur.

Në mënyrë që agjentët të fitojnë të drejtën për të hyrë në një fushë sociale të caktuar duhet të zotërojnë një sasi dhe strukturë të caktuar kapitalesh (Bourdieu 1986). Në librin e tij *The Logic of Practice* (Bourdieu 1992) pohon se ndërveprimi midis kapitalit, fushës sociale dhe habitusit përcakton strategjinë apo veprimin e agjentit. Praktika njerëzore është rezultat i strukturës sociale dhe njëkohësisht projektim i habitusit në një fushë sociale të caktuar. Habitusi si një sistem i qëndrueshëm apo strukturë perceptimi, konceptimi dhe veprimi, i mësuar dhe përbrendësuar prej subjektit që e orienton atë në botën sociale, është njëkohësisht garancia e besimit në rregullat e lojës sociale. Nisur prej këtij kushti, agjentët veprojnë në bazë të *doxa-s* (pozicionit të tyre në fushë, ashtu si edhe kufijve të mobilitetit social brenda një fushe të caktuar), e cila varet prej grupit shoqëror apo klasës në të cilën bën pjesë dhe strukturës e sasisë së kapitalit ekonomik, kulturor dhe social që zotërojnë (Bourdieu 2013, 164).

Kapitalet e trashëguara nga rendi socialist, në mënyrë të veçantë kapitali kulturor dhe kapitali social, siç pohohet prej vetë anëtarëve të pakicës, bëhen pengesë e rëndësishme në rrugëtimin e tyre përgjatë post-socializmit. Në një rend të ri që po krijohet pas rënies së rendit të mëparshëm, supozohet që të gjitha kapitalet të gjenden në hapësirën e re

sociale, si të tilla, në princip të ishin të arritshme. Por, në këtë kontekst, kapitali kulturor dhe social i trashëguar përbënte një avantazh të konsiderueshëm në luftën për kapitale midis agjentëve. Thënë kjo, duke konsideruar faktin që për pjesën dërrmuese të popullatës ishte akumuluar pak kapital ekonomik gjatë rendit socialist, ose edhe ajo çka ishte krijuar zhvlerësohej, ose të paktën vlera e saj relativizohej në sistemin e ri. Ndaj supozohet që në këtë aspekt, veç të tjerash (duke mos qenë e mundur në këtë tekst të analizohen edhe variabla të tjerë) kapitali social dhe kapitali kulturor të jenë burim i rëndësishëm për të zgjeruar kapitalin ekonomik.

Kapitali social është tërësia e marrëdhënieve sociale, agregati i burimeve aktuale apo potenciale që mund të gjenerohen nga familja, grupi apo klasa në të cilën individi bën pjesë. “Volumi i kapitalit social që zotëron një agjent varet prej përmasave të network-ut që efektivisht ai mund të mobilizojë” (Bourdieu 1986, 248-249). Në këtë kontekst, siç u shtjellua edhe më lart, përmes arsytimit mbi rrjetet sociale është e qartë që për këtë komunitet të pakicës rrome kapitali i kufizuar social nuk mundëson shfrytëzimin e burimeve të mirëqenies, duke e reduktuar në pranimin e punëve dhe aktiviteteve ekonomike më të marginalizuara. Ndërsa kapitali kulturor transferohet përmes familjes dhe edukimit formal dhe shpërfaqet në tri forma: si i trupëzuar (apo i përbrendësuar), i objektifikuar dhe i institucionalizuar (Bourdieu 1986, 243). Hallka më e rëndësishme brenda logjikës së shtetit modern në kultivimin e këtij kapitali është certifikimi i edukimit përmes institucioneve që janë mandatuar për të ekzekutuar këtë funksion. Edukimi formal është elementi më bazik në sigurimin e kapitalit social dhe simbolik (Bourdieu 1986, 244). Mungesa e kapitalit kulturor të institucionalizuar nënvizohet prej vetë anëtarëve të komunitetit si një faktor me shumë peshë në përcaktimin e pozitës së tyre shoqërore dhe mundësisë së mobilitetit social gjatë post-socializmit. Ndër frazat që artikullohet më shpesh prej tyre është se “ne jemi pashkollë, ndaj dhe nuk ia kemi dalë”. Madje, për këtë arsye përgjithësisht fajësojnë vetveten, si pranim të asaj çka në këndvështrimin e Bourdieu-së njihet si dhunë simbolike. Në këtë kuptim edukimi është pashmangshmërisht dhunë simbolike me qëllim ruajtjen e raportit aktual të forcave, të riprodhimit të strukturës sociale ekzistuese e të kulturës dominuese (Bourdieu dhe Passeron 1990, 5-6).

Këto qëndrime të komunitetit të Lanabregasit manifestojnë njëkohësisht edhe mospërputhjen midis pritshmërisë së artikulluar nga jashtë (për sa unë si studiues në këtë takim përfaqësoj tjetrin); kjo si derivat i strukturës në të cilën arsimimi qëndron si një prej vlerave më të rëndësishme nga njëra anë dhe diapazonit të mundësive, interesave e aspiratave të komunitetit në fjalë nga ana tjetër. Me terma të tjerë, si rezultat i gravitetit të së tashmes, ajo çka artikullohet nga jashtë, si panacea, përvetësohet si ideal prej tyre, por nuk besohet plotësisht e, për rrjedhojë, nuk aplikohet. Nisur prej kushteve aktuale bëhet e pamundur të përfytyrojnë se si kjo mund të bëhet një instrument shpëtimi, qoftë edhe në të ardhmen, ndaj dhe nuk motivohen që t'i orientojnë fëmijët e tyre drejt arsimimit. Natyrisht, kjo shkon përtej romëve, ndaj dhe Bourdieu me të drejtë argumenton se mekanizmi më i rëndësishëm në përmbushjen e qëllimit të çdo rendi për natyralizimin e arbitraritetit të prodhuar prej vetë atij është dialektika midis shanseve objektive dhe aspiratave të agjentit, që prodhon atë çka njihet rëndom si sensi i realitetit (Bourdieu 2013, 164).

Është e nevojshme të theksohet se veçanërisht sfera e edukimit është një territor i jetës shoqërore, që ndihmon të kuptojmë se si ndodh riprodhimi i strukturës dhe pozicionit social të grupeve shoqërore të nënrenditura, siç janë edhe romët e varfër. Bernstein-i nënvizon se performanca e fëmijës përgjatë procesit të nxënies në kuadrin e edukimit formal kushtëzohet që në fillimet e tij nga formimi që përftohet në familje. Klasa rregullon strukturën e komunikimit brenda familjes, si zanafilla e kodifikimit të orientimit sociolinguistik të fëmijës (Bernstein 2003). Edhe për Bourdieu-në kodi gjuhësor kushtëzon individin (Bourdieu, Passeron 1990, 43). Në terma të tjerë, aftësia dhe mundësia për të përthithur kapital kulturor institucional kalon përmes kapitalit kulturor të përbrendësuar.

Mbështetur në këtë paradigmë, në rastin tonë manifestohen disa pengesa që e vështirësojnë marrëdhënien normale me edukimin institucional të kësaj pakice. Së pari, gjuha e komunikimit në familje është romisht dhe, për rrjedhojë, kjo bëhet pengesë bazike për një performancë të suksesshme në arsimim, e evidentuar në shumë raste edhe nga vëzhgimet empirike si e tillë. Së dyti, kemi të bëjmë vetëm me gjuhë të folur me shumë varietete dhe të transmetuar nga prindër të pashkolluar, duke rritur gjasat që të mos përvetësohen kategori të njohjes, që, referuar Bernstein-it, janë thelbësore

për performimin në edukimin institucional. Së treti, në këto rrethana vetë gjuha bëhet një strukturë që ndikon në thellimin e distancës sociale midis këtij formacioni shoqëror dhe pjesës tjetër të shoqërisë, duke u bërë kusht i rëndësishëm jo vetëm për riprodhimin e kushteve materiale ekzistuese, por me gjasa edhe të kulturës.

### **Në vend të mbylljes: habitusi si koncepti analitik që ndihmon në shpjegimin e riprodhimit të strukturës dhe vetes**

Është e kuptueshme nga çfarë diskutuam deri më tani që qerthulli i mbyllur i varfërisë bën që edhe breznitë e reja të mos artikulojnë si agjentë ndryshimi, por, më së shumti, si rojtarë të status-quo-së<sup>8</sup>. Të kushtëzuar nga rrethanat, në familje ushtrohet një lloj pedagogjie e mbijetesës e projektuar në ushtrimin e aftësisë për mbijetesë, e aftësisë për të administruar të tashmen. Idealet për të ardhmen nuk mungojnë, por të kufizuar në kapitale, të izoluar në komunitete të mbyllura, në pamundësi aksesit të rrjeteve sociale përtëj komunitetit përkatës, të segreguar fizikisht dhe të stigmatizuar, ato braktisen, ose të paktën lihen mënjane për sa kohë perceptohen si pengesë në administrimin e së tashmes. Pasiguria bashkëkohore e modernitetit të lëngët, kombinuar me pasiguritë kontekstuale të Shqipërisë dhe me pasiguritë ekskluzive të një pakice të përjashtuar prodhojnë, si rezultat, artikullimin e ekzistencës si vetëmbrojtje më shumë se sa prirjen për t'u vetëvendosur si agjent ndryshimi.

Gjithashtu duhet konsideruar fakti se romët e varfër në përfytyrimin e shumicës përmbushin imazhin e 'tjetrës perfekte', (lehtësisht të përjashtueshme) si tjetri ekstremisht i varfër, raca tjetër dhe kultura tjetër. Mbi këto premisa ushtrimi i pushtetit të shumicës ndaj pakicës nuk është vetëm ushtrim mekanik force i numrave të mëdhenj ndaj numrave të vegjël, por edhe jetësim i pashmangshëm i esencjalizmave të modernitetit (Appadurai 2006).

---

<sup>8</sup> Natyrisht kjo nuk është veçori specifike as e komunitetit të Lanabregasit, as e pakicës rome në përgjithësi, por e shumë grupimeve shoqërore apo shoqërive që, të detyruar nga jashtë, ose në disa raste edhe si zgjedhje, prirjen të ruajnë statusin shoqëror apo gjendjen ekzistuese.

Foucault-i sugjeron që të mos e shohim pushtetin “si dukuri masive dhe homogjene [...] si diçka që ndahet midis atyre që e kanë dhe e zotërojnë pa përjashtim dhe atyre që nuk e kanë, por e vuajnë dhe e pësojnë [...], por si diçka që qarkullon, ose si diçka që funksionon vetëm në zinxhir”. Kjo do të thotë të studiosh trupat periferikë jo vetëm si hallka fundore e zinxhirit, por si trupa të nënvarur, që nën efektin e pushtetit formësohen si subjekte (Foucault 2009, 103).

Por ndryshe nga Foucault që e sheh pushtetin të kudondodhur, Bourdieu e lexon si produkt të ndërveprimit midis strukturës dhe agjencisë. Bourdieu me paradigmen e tij përpiqet të tejkalojë dualitetin midis perspektivës strukturaliste, që e redukton individin në një qenie tërësisht të programuar dhe asaj të agjencisë, që i konsideron individët si tërësisht të lirë. Habitusi pasqyron marrëdhënien dialektike midis strukturës dhe dispozitave përbërëse të vetë habitusit (Bourdieu, 2013, 84). “Habitusi është një sistem i qëndrueshëm dhe i zhvendosshëm dispozitash, strukturë e strukturuar e predispozuar të funksionojë si strukturë strukturuese”. (Ibid. 72). Kësisoj, habitusi është “opus operatum” dhe “modus operandi” (Bourdieu 1984, 172).

Domethënë, agjentët nuk janë thjeshtë aktorë socialë pasivë, që në skenën e tyre të jetës drejtohen nga forca jashtë fushës sociale, por mund të përpunojnë strategjitë e tyre të veprimit duke ushtruar një shkallë të caktuar agjencie. Por problemi është që habitusi, si shtrati botëkuptimor ku plazmohet sjellja e agjentit, varet si prej të kaluarës së përbrendësuar, ashtu edhe prej dinamicitetit të së tashmes dhe projeksioneve inercike të së ardhmes. Nga njëra anë habitusi i parë apo habitusi klasor siç emërtohet nga Bourdieu, është gjithçka përvetësohet në fëmijëri përmes prindërve, mbështetur në pozicionin e tyre klasor. Ky është themeli i shijes, interesave, stilit e mënyrës së jetesës në përgjithësi të individit, që konfigurron marrëdhënien dhe përvijon dallimin midis klasave të ndryshme sociale (Bourdieu 1984, 101). Nga ana tjetër, duke qenë se habitusi i individit është njëkohësisht rezultat i edukimit formal e përvojës jetësore, përbën një mundësi ndryshimi për agjentin. Kjo, pavarësisht peshës që mbart habitusi i parë në përcaktimin e trajektores jetësore të agjentit social, i cili meqenëse rrjedh nga pozicioni i tij/saj në fushën sociale garanton funksionimin e kufijve socialë të sjelljes tonë shoqërore. Kësisoj, habitusi

pashmangshmërisht riprodhon strukturën (Bourdieu 2013, 83), për shkak të përshtatjes thujtse të përsosur midis strukturës objektive dhe strukturës së përbrendësuar. Për rrjedhojë, “rendi kozmologjik dhe politik perceptohet jo si arbitrar, por si një rend vetë-evident dhe natyror që nuk vihat në pikëpyetje. Aspiratat e agjentit reflektojnë të njëjtat kufizime me kushtet objektive produkt i të cilave janë” (Bourdieu 2013, 166).

Romi i varfër, megjithëse në premisë, e mbart mundësinë për të qenë një agjent social i lirë, habitusi që rrjedh prej një pozite sociale të nënrenditur nuk ia mundëson ndryshimin e gjendjes. Ndaj, nuk i mbetet asgjë më shumë se sa të dorëzohet e të pranojë kushtet ekzistuese, i bindur shpeshherë që kjo është ajo çka meriton. Për rrjedhojë, jo vetëm si reagim ndaj impulsit të jashtëm (siç edhe shpeshherë keqkuptohet), por në ndërveprim me këtë strukturë, me një vetëdije sa të tijën, po aq edhe të imponuar nga jashtë, jo vetëm pranon, por i jep kuptim administrimit të ekzistencës në të tashmen dhe riprodhimit të strukturës e të vetes.

Me çfarë u tha, nuk po mbrohet ideja se habitusi i komunitetit më të varfër të romëve nuk mund të ndryshojë, por kjo kërkon kohë dhe ndryshime rrënjësore të kushteve objektive, për sa habitusi është pazgjidhshmërisht i lidhur me fushën sociale dhe kapitalet dhe për sa marrëdhënia mes tyre prodhon praktiken (Bourdieu 1984, 101). Ndaj është thelbësore të kuptohet që nuk mund të shpjegohet gjendja e tyre vetëm përmes analizës së strukturës ekonomike, ashtu siç edhe nuk mund të zgjidhet vetëm me arnime ekonomike të imponuara nga jashtë, që nuk marrin parasysh habitusin e tyre.

### **Bibliografi**

- Appadurai Arjun. 2006. *Frikë nga numrat e vegjël, një ese për gjeografinë e zemërimit*. Përkthyer nga Virgjil Muçi. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias.
- Bauman, Zygmunt. 2017. *Moderniteti i lëngët*. Përkthyer nga Dritan Xhelo. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- Barth, Fredrik. 1969. *Ethnic Groups and Boundaries*. Boston: Little Brown and Company.
- Bernstein, Basil. 2003. *Class, Codes and Control, volume III Towards a Theory of Educational Transmission*. London: Routledge.

- Bourdieu, Pierre dhe J. Claude Passeron. 1990. *Reproduction in Education, Society and Culture*. London: Sage Publications.
- Bourdieu, Pierre. 2013. *Outline of a Theory of Practice*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Bourdieu, Pierre. 1992. *The logic of practice*. California: Stanford University Press.
- Bourdieu, Pierre. 1986. "The Forms of Capital". Në *Handbook of Theory and Research for the Sociology of Education*, përgatitur nga J. E. Richardson: 241-258. New York: Greenwood Press.
- Bourdieu, Pierre. 1984. *Distinction: A Social Critique of the Judgement of Taste*. Cambridge Massachusetts: Harvard University Press.
- Çeka, Blendi dhe Ervin Kaçiu. 2015. *Hulumtim mbi profilin socio-politik të popullatës rome në Shqipëri*. Konsultuar për herë të fundit më 3 shtator 2019, [https://www.osfa.al/sites/default/files/hulumtim\\_mbi\\_profilin\\_socio-politik\\_te\\_popullates\\_rome\\_ne\\_shqiperi.pdf](https://www.osfa.al/sites/default/files/hulumtim_mbi_profilin_socio-politik_te_popullates_rome_ne_shqiperi.pdf)
- Eriksen, Thomas Hylland. 2005. "Economies of Ethnicity"/ Në *A handbook of economic anthropology*, përgatitur nga Carrier G. James, 353-369. Cheltenham: Edward Elgar Publishing.
- Eriksen, Thomas Hylland. 2001. *Small Places, Large Issues: An Introduction to Social and Cultural Anthropology (Anthropology, Culture and Society)*. London: Pluto Press.
- Foucault, Michel 2009. *Pusheteti dhe dija*. Përkthyer nga Orgest Azizi, Persida Asllani. Tiranë: ISP& Dita 2000.
- Geertz, Clifford 1973. *The interpretation of cultures selected essays*. New York: Basic Books, Inc., Publishers.
- Lewis, Oscar. 1975. *Five Families: Mexican Case Studies in the Culture of Poverty*. New York: Basic Books.

